



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

DEKLARATË

Unë i poshtënëshkruari _____ nga _____ me nënshkrimin e këtij dokumenti deklaroj se si anëtar i licencuar nga ana e FBK-së do t'i zbatoj me përpikëri udhëzimet dhe masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës për mbrojtje nga COVID-19.

Duke nënshkruar këtë deklaratë, deklaroj se jam në dijeni të Udhëzuesit për masat mbrojtje ndaj COVID-19 dhe se të njëjtin e kam pranuar dhe lexuar para nënshkrimit të kësaj deklaratë dhe konfirmimit se:

- Deklaroj se pjesëmarrjen në aktivitete të basketbollit e konfirmoj me vullnet dhe në bazë të vlerësimit tim të lirë dhe se për çfarëdo çështje që ndërlidhet me pjesëmarrjen time në këto aktivitete nuk do të kërkoj kurrfarë përgjegjësie materiale, juridike apo të formave tjera nga Federata e Basketbollit të Kosovës.

- 72 orë para fillimit të edicionit 2020-2021 do të testohem për COVID-19. Mostestimi do të jetë masë ndaluese për paraqitjen time në ndeshjet e basketbollit dhe çfarëdo aktiviteti tjetër që organizohet nga FBK.

- Gjatë kohës së stërvitjes/ndeshjes do t'i respektojë udhëzimet për bartjen e maskës, mbajtjen e distancës fizike, përdorimin e mjeteve dezinfektuese me përbërje 70% alkool dhe udhëzimeve tjera.

- Para fillimit të stërvitjes/ndeshjes do të lejoj matjen e temperaturës nga ekipi mjekësor, si dhe në rast se do të ndjej çfarëdo simptoma të gripit, përfshirë temperaturën e ngritur të trupit, kollën, teshtitjen dhe të gjitha simptomat e ngjashme, unë nuk do të paraqitem në stërvitje dhe/ose në ndeshje dhe me kohë do të njoftojë udhëheqësit e klubit.

- Gjatë stërvitjes/ndeshjes nuk do të përshëndetem me duar, nuk do të bartë ushqim me vete, fashat e përdorura do t'i hedh në shportën e mbeturinave, nuk do të tubohem në grupe dhe do të kujdesem për higjienën personale.

www.basketbolli.com





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

- Pas përfundimit të stërvitjes/ndeshjes do të mundohem të largohem sa më shpejtë nga salla dhe nuk do të ndalem në aktivitete sociale dhe nuk do të shfrytëzojë dush kabinat për pastrim.
- Gjatë organizimit të transportit do të mundohem të shfrytëzojë transportin personal, në të kundërtën do të mbajë distancën sociale gjatë transportit të përbashkët.
- Deklaroj se do të ruaj dhe do kujdesem për shëndetin tim dhe do të mundohem të ruaj edhe shëndetin e bashkëlojtarëve, kolegëve, kundërshtarëve dhe personave tjerë zyrtarë në të gjitha aktivitetet basketbollistike gjatë tërë kohës sa do të janë në fuqi masat e luftimit të COVID-19.

Nënshkrimi: _____

Data: _____

www.basketbolli.com

